



Pranuar / Dorëzuar Prijmjenj/Prudato Received/Delivery	12-06-2023	3	viti god. year
Organ /Njesia Organ /Jedinica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SIKSHACK	4710/2023		115



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.689/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Eshref Shabani-kryetar, Arben Mehmeti dhe Ardita Haxhnikaj-Demi-anëtarë, me Flakron Gashi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.689/2023 të datës 28.04.2023 të parashtruar nga ankuesi me adresë banimi:

kundër Vendimit me numër 399/2023 të datës 14.04.2023 të Kryesuesit të Sekretariatit të Organit Shqyrtues të Prokurimit, në çështjen juridike "Kërkesë nga marrëdhënia e punës", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim me datë 12.06.2023, mori këtë:

V E N D I M

I. Refuzohet si e pabazuar ankesa me numër A.nr.689/2023 e datës 28.04.2023 e parashtruar nga ankuesi

II. Mbetet në fuqi Vendimit me 399/2023 të datës 14.04.2023 të Kryesuesit të Sekretariatit të Organit Shqyrtues të Prokurimit.

A r s y e t i m

Ankuesi sipas shkresave të lëndës i punësuar në Organin Shqyrtues të Prokurimit, më datë 28.04.2023 ka parashtruar ankesë me numër protokollit 3913/2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit me numër 399/2023 të datës 14.04.2023 të Kryesuesit të Sekretariatit të Organit Shqyrtues të Prokurimit.

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshill pretendon se Organi Shqyrtues i Prokurimit me rastin e nxjerrjes së Vendimit me numër 399/2023 të datës 14.04.2023 mbi shfuqizimin e Vendimit me numër 919/2021 të datës 28.12.2021 ka shkelur dispozitat e ligjit material dhe i njëjti është i kundër ligjshëm duke marrë parasysh se ekziston një vendim paraprak ku ankuesit i është njohur e drejta e



pezullimit të marrëdhënies së punës deri në përfundimin e mandatit për pozitën “Drejtor i Drejtorisë për Punë Inspektuese” në Komunën e Gjakovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës me datën 22.02.2023 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë të ankuesit tek Organi i Shqyrtues i Prokurimit. Ndërsa me datën 12.05.2023 Këshilli ka pranuar përgjigjen në ankesë me shkresat e bashkangjitura.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, për shqyrtimin e kësaj lënde ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokoll 3913/2023 të datës 28.04.2023 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendim me numër 399/2023 i datës 14.04.2023; Vendim me numër 319/21 i datës 28.12.2021; E-mail i dërguar nga drejtuar e datës 17.03.2023; E-mail i dërguar nga drejtuar e datës 03.03.2023; E-mail i dërguar nga drejtuar e datës 28.10.2022; E-mail i dërguar nga drejtuar drejtuar 27.10.2022; E-mail i dërguar nga drejtuar e datës 28.09.2022; E-mail i dërguar nga drejtuar e datës 20.09.2022; E-mail i dërguar nga drejtuar e datës 27.05.2022; E-mail i dërguar nga drejtuar E.S e datës 10.01.2022; Kërkesa për pezullimin e marrëdhënies së punës me numër 909/21 e datës 23.12.2021; E-mail i dërguar nga drejtuar e datës 20.09.2022; Përgjigja në ankesë e datës 12.05.2023; Akt emërimi me numër 165/2012 e datës 02.05.2012; Vendim me numër 01-112/01-38402 i datës 22.12.2021; E-mail i dërguar nga drejtuar e datës 14.04.2023.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, për vendosjen e kësaj çështje, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës, ka konstatuar se janë plotësuar kushtet ligjore për procedimi administrativ të filluar me ankesën e ankuesit, *sepse*:

Nga administrimi i provave të lëndës Kolegji i Këshillit ka gjetur se ankuesi sipas Akt Emërimit me numër 165/2012 të datës 02.05.2012 ka qenë i emëruar në pozitën “Ekspert Shqyrtues” në Organin Shqyrtues të Prokurimit, ndërsa përmes Vendimit me numër 01-112/01-38402 të datës 22.12.2021 të Kryetarit të Komunës së Gjakovës ankuesi është emëruar në pozitën “Drejtor i Drejtorisë për Punë Inspektuese” në Komunën e Gjakovës. Tutje, ankuesi me datën 23.12.2021 kishte paraqitur kërkesë me numër 909/2021 në Organin Shqyrtues të Prokurimit duke kërkuar pezullimin e marrëdhënies së punës në Shërbimin Civil për shkak të marrjes së detyrës së funksionarit publik deri në përfundimin e mandatit si “Drejtor” në Komunën e Gjakovës, ndërsa Kryesuesi i Sekretariatit të Organit Shqyrtues të Prokurimit ka nxjerrë Vendimin me numër 919/21 të datës 28.12.2021 mbi bazën e të cilit ankuesit i është aprovuar kërkesa për pezullimin e marrëdhënies së punës në Shërbimin Civil deri në përfundimin e mandatit si “Drejtor i Drejtorisë për Punë Inspektuese” në Komunën e Gjakovës.

Tutje, Organi Shqyrtues i Prokurimit kishte kërkuar sqarim nga DMZP/MPB lidhur me atë se si duhet të veprohet me rastin e zëvendësimit të pozitës së lirë deri në kthimin e zyrtarit që i është pezulluar vendi i punës. Ndaj të njëjtës kërkesë DMZP/MPB kishte dhënë përgjigjen përmes emailit të datës 27.05.2022 ku ka sqaruar se një pozitë e rregullte në Shërbimin Civil mund të plotësohet në rast të nevojës për zëvendësim për një periudhë jo më të gjatë se 12 muaj, andaj për plotësimin e pozitës që pezullohet me gjatë se 12 muaj duhet të hapet konkurs, ndërsa pas përfundimit të pezullimit të marrëdhënies së punës, nëpunësi ka të drejtë të kthehet në vendin e njëjtë të punës nëse pozita është akoma e lirë në të kundërtën nëse pozita është plotësuar ai transferohet në një vend tjetër të punës të të njëjtës kategori.



Organi Shqyrtues i Prokurimit lidhur me mendimin e dhënë të DMZP, kishte njoftuar ankuesin dhe përmes e-mailit të datës 03.03.2023 ka kërkuar nga i njëjti që deri me datën 17.03.2023 me shkrim të njoftoj OSHP-në, se a do të kthehet në vendin e punës apo to të vazhdoj marrëdhënien e punës në institucionin ku është emëruar, ndërsa ankuesi kishte njoftuar institucionin punëdhënës se lidhur me pozitën e tij si “Drejtor i Drejtorisë për Punë Inspektuese” nuk është ndryshuar asnjë rrethanë dhe ankuesi nuk është kthyer në pozitën në fjalë. Tutje, Kryesuesi i Sekretariatit të OSHP-ka nxjerrë Vendimin me numër 399/2023 të datës 14.04.2023 përmes të cilit ka shfuqizuar Vendimin paraprak me numër 919/2021 të datës 28.12.2021 me arsyetimin se një pozitë në shërbimin civil nuk mund të pezullohet për një periudhë më të gjatë se 12 muaj duke u bazuar edhe në mendimin e dhënë nga DMZP.

Kolegji i Këshillit ka analizuar edhe dispozitat ligjore të nenit 56 par.1 pika 1.2 të Ligjit nr. 06/L - 114 për Zyrtarët Publikë ku theksohet fakti se: “1. Nëpunësi civil pezullohet, sipas detyrës zyrtare të organit përkatës të punëdhënësit, në rastet si në vijim: 1.2. kur emërohet në një nga funksionet e parashikuara në paragrafët 1.1 dhe 1.2 të nenit 3 të këtij ligji, për periudhën përkatëse të emërimit”, ndërsa me nenin 3 paragrafi 1, 2 dhe 3 të Ligjit Nr.06/L - 114 për Zyrtarët Publikë ka përcaktuar qartë se kush hynë në kategorinë e funksionarëve publik sikurse: “1. Ky ligj nuk zbatohet për: 1.1. funksionarët publikë; 1.2. funksionarët publikë me status të veçantë. 2. Funksionarë publikë, në kuptimin e nënparagrafit 1.1 të këtij neni, janë: 2.1. të zgjedhurit; 2.2. anëtarët e Qeverisë dhe zëvendësit e tyre; 2.3. funksionarët e emëruar nga Kuvendi apo nga Presidenti i Republikës dhe titullarët apo anëtarët e organeve drejtuese kolegjiale të institucioneve të pavarura dhe të agjencive të pavarura. 3. Funksionarë publikë me status të veçantë, në kuptimin e nënparagrafit 1.2 të këtij neni janë: 3.1. gjyqtarët dhe prokurorët; 3.2. personeli komandues dhe ushtarak të Forcës së Sigurisë së Kosovës apo të organizatës tjetër pasardhëse; 3.3. zyrtarët policor të Kosovës dhe inspektorati policor i Kosovës; 3.4. zyrtarët doganor të Kosovës; 3.5. personeli drejtues dhe punonjësit e Agjencisë Kosovare të Inteligjencës. 3.6. drejtori apo anëtarët e organit drejtues kolegjial të agjencive rregullatorë” nga rrjedh se pozita në të cilën është emëruar ankuesi, gjegjësisht pozita “Drejtor i Drejtorisë për Punë Inspektuese” në Komunën e Gjakovës nuk hynë në asnjërën nga kategoritë e përcaktuara të funksionarëve publikë sipas nenit 3 paragrafi 1, 2 dhe 3 të Ligjit nr. 06/L - 114 për Zyrtarët Publikë, gjegjësisht emërimi i ankuesit është bërë sipas Vendimit me numër 01-112/01-38402 të datës 22.12.2021 të Kryetarit të Komunës së Gjakovës, nga rrjedh se pozita në të cilën është emëruar ankuesi hynë në kategorinë **Nëpunësi i Kabinetit** sikurse përcaktohet me nenin 2 paragrafi 5 i Ligjit nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë: “5. Nëpunësi i Kabinetit - është zyrtari publik, që ushtron detyrën në Kabinetin e Presidentit, të Kryetarit të Kuvendit, të Kryetarit të Gjykatës Kushtetuese, të Kryeministrit, të Zëvendëskryeministrit, të Ministrit ose të titullarit të një institucioni të pavarur kushtetues dhe të Kryetarit të Komunës. Statusin e nëpunësit të Kabinetit e kanë edhe nëpunësit të cilët ushtrojnë detyrat për nën kryetarin e Kuvendit të Kosovës dhe për grupin parlamentar” si dhe nenit 76 paragrafi 1 dhe nenit 77 paragrafi 1 i të njëjtit ligj ku përcaktohet se: “Marrëdhënia e punës e zyrtarit të kabinetit është marrëdhënie besimi me titullarin e kabinetit të cilit i shërben zyrtari; 1. Nëpunësi i kabinetit përzgjidhet dhe emërohet në detyrë, lirisht, nga titullari i kabinetit”, prandaj në rastin konkret nuk ka pasur bazë ligjore që ankuesit t’i pezullohet marrëdhënia e punës në Shërbimin Civil pasi që nuk janë përmbushur asnjëri nga kriteret e parapara ligjore të përcaktuara në nenin 56 dhe 57 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik gjegjësisht nuk janë përmbushur asnjëri nga parakushtet lidhur me pezullimin sipas detyrës zyrtare apo pezullimit vullnetar.

Prandaj nga se u tha si më lartë, lidhur me pretendimin ankimor të ankuesit se Organi Shqyrtues i Prokurimit përmes Vendimit me numër 919/2021 të datës 28.12.2021 e kishte aprovuar kërkesën për pezullimin e marrëdhënies së punës deri në përfundimin e mandatit dhe se shfuqizimi i saj do të



ishte i kundërligjshëm, Kolegji i Këshillit ka analizuar dispozitat e nenit 53 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative ku përcaktohet se: *“Një akt administrativ mund të anulohet apo shfuqizohet, sipas detyrës zyrtare, nga organi publik që ka kompetenca të nxjerrë aktin, nga organi i tij mbikëqyrës apo nga një organ tjetër i përcaktuar shprehimisht me ligj”* si dhe nenit 58 paragrafi 2 lidhur me nenin 55 paragrafi 1 i të njëjtit ligj ku përcaktohet se: *“Anulimi apo shfuqizimi, në çdo rast tjetër mund të bëhet brenda tridhjetë (30) ditëve nga data kur organi publik i përcaktuar sipas paragrafit 1 të nenit 53 të këtij Ligji, njihet me faktet që justifikojnë anulimin apo shfuqizimin, por jo me vonë se pesë (5) vjet nga njoftimi i aktit administrativ”*; *“1. Një akt administrativ i paligjshëm për arsye të tjera nga ato ta parapara nga neni 54 i këtij Ligji, mund të anulohet apo të shfuqizohet, me qëllimin për të vendosur ligjshmërinë”* dhe ka ardhur në përfundimin se Kryesuesi i Sekretariatit të Organit Shqyrtues të Prokurimit me rastin e nxjerrjes së Vendimit me 399/2023 të datës 14.04.2023 ka vendosur në pajtueshmëri me dispozitat e lartcekura ligjore me qëllim të kthimit të ligjshmërisë në rastin kur e ka shfuqizuar Vendimin paraprak me numër 919/21 të datës 28.12.2021 ngase i njëjti nuk ishte nxjerrë në pajtueshmëri me dispozitat e ligjit material që përcaktohet së në cilat raste mund të bëhet pezullimi i marrëdhënies së punës në Shërbimin Civil.

Pas analizimit të shkresave të lëndës të ofruara nga palët në procedurë si dhe konstatimeve të dhëna si në arsyetimin e këtij vendimi, Kolegji i Këshillit ka konstatuar se pretendimet ankimore të ankuesit janë të pabazuara ndërsa ankesa e tij e datës 28.04.2023 është refuzuar sikurse në dispozitivin e këtij vendimi, andaj në kuptim të nenit 132 paragrafi 3 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative ku përcaktohet se: *“Nëse organi epror vlerëson se pjesa urdhëruese (dispozitivi) i aktit të ankimuar është i ligjshëm, por arsyet e dhëna janë të tjera nga ato që i ka dhënë organi kompetent publik në aktin e ankimuar, apo vlerëson se arsyetimi i tij nuk është i plotë, ai do të refuzojë ankesën dhe do të paraqes arsyetimin e ri, gjegjësisht do ta plotësojë arsyetimin aktit të ankimuar”*, Kolegji i Këshillit vlerëson se vendimi i kontestuar, gjegjësisht Vendimi me numër 399/2023 të datës 14.04.2023 i Kryesuesit të Sekretariatit të Organit Shqyrtues të Prokurimit është akt administrativ është i ligjshëm mirëpo arsyetimi i përdorur në këtë vendim nuk është i plotë, prandaj mbështetur në këtë dispozitë ligjore, Kolegji i Këshillit thekson faktin se arsyetimi i vendimit të Këshillit është arsyetim plotësues i vendimit të kontestuar nga pala ankuese.

Kolegji i Këshillit thekson faktin se opinionet e dhëna ligjore përmes e-mailit të datës 10.01.2022 nga zyrtarët e Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik nuk e kanë fuqinë e normës ligjore, gjegjësisht një çështje e tillë është e rregulluar shumë qartë me dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik se në cilat raste dhe për cilat pozita të parashikuar mund të bëhet pezullimi i marrëdhënies së punës në Shërbimin Civil, nga rrjedh se mbi këtë bazë meqenëse ankuesit i është bërë pezullimi i marrëdhënies së punës nga institucioni punëdhënës mbi bazën e interpretimeve të gabuara të dispozitave të ligjit material, i njëjti nuk mund të dëmtohet në rastin konkret, mirëpo në pajtueshmëri nenin 58 paragrafi 1 të Ligjit nr. 06/1 - 114 për Zyrtarët Publikë ku përcaktohet se: *“1.Pas përfundimit të pezullimit, përveçse kur vendoset përfundimi i marrëdhënies së punës në Shërbimin Civil, sipas këtij ligji, nëpunësi civil rikthehet në pozitën e mëparshme të punës ose në rast se pozita e mëparshme është e plotësuar përfundimisht, ai transferohet në një vend tjetër të së njëjtës kategori”*, ankuesi ka të drejtën që të kthehet në vendin e tij të punës sipas Akt Emërimit me numër 165/2012 të datës 02.05.2012 ku ka qenë i emëruar në pozitën *“Ekspert Shqyrtues”* pranë Organit Shqyrtues i Prokurimit, mirëpo i njëjti nuk mundet në të njëjtë kohë ta ushtrojë pozitën e *“Drejtorit të Drejtorisë për Punë Inspektuese”* në Komunën e Gjakovës dhe ta mbajë të pezulluar marrëdhënien e punës në Shërbimin Civil.



Prandaj, nga se u tha si më lartë, ankuesi duhet ta ketë parasysh faktin se Vendimi i datës 21.12.2021 me numër:919/21 i nxjerrë nga Kryesuesi i Sekretarit të Organit Shqyrtues të Prokurimit përmes të cilit ankuesit i është pezulluar marrëdhënia e punës sipas detyrës zyrtare, tani e tuje më nuk prodhon efekte juridike, gjegjësisht i njëjtë është shfuqizuar për shkak se është nxjerrë në kundërshtim me dispozitat e aplikuara të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik, nga rrjedh se ankuesi është i obliguar të kthehet në vendin e punës, ndërsa nëse i njëjti refuzon të kthehet në vendin e tij të punës, ky veprim i tij përbënë shkak për lirim nga Shërbimi Civil sikurse përcaktohet me dispozitat e nenit 61 paragrafi 1 nën paragrafi 1.7 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik.

Andaj, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës dhe konstatimeve të dhëna, bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe nenin 132 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

**KËSHILLI I PAVARUR MBIQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
Lënda me numër **A.nr.689/2023**

**Flakron GASHI**

*Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional*

**Eshref SHABANI**

*Kryetar i Kolegjit*

**Vendimi i dërgohet**

- Ankuesit
- Kryesuesit të Sekretariatit të Organit Shqyrtues të Prokurimit;
- Drejtorit të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Inspektoratin e Punës dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.